

VENDIM
Nr. 236, datë 21.3.2017

PËR LËVIZJEN JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË 22
VEPRAVE TË AUTORIT SHQIPTAR
ZEF SHOSHI, ME QËLLIM HAPJEN E EKSPOZITËS PERSONALE TË AUTORIT, ME
TITULL “ZEF SHOSHI, VEPRA 1956–2014”, QË ORGANIZOHET NGA GALERIA
KOMBËTARE E ARTEVE, TIRANË NË GALERINË KOMBËTARE TË KOSOVËS,
PRISHTINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 22 (njëzet e dy) veprave të autorit shqiptar Zef Shoshi, me qëllim hapjen e ekspozitës personale të autorit, me titull “Zef Shoshi, vepra 1956–2014”, që organizohet nga Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë në Galerinë Kombëtare të Kosovës, Prishtinë, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lejimi i lëvizjes së veprave të bëhet nga data 24 mars deri më 5 maj 2017.

3. Ekspozimi i veprave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e lëvizjes së objekteve të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta, kombëtare dhe unike, për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

4. Ngarkohen Galeria Kombëtare e Arteve të kryejë shoqërimin dhe kthimin e veprave në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë, dhe Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.

5. Ngarkohet ministri i Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista e veprave të ZEF SHOSHIT për Ekspozitën në GKK-Prishtinë (nga koleksioni I GKA)

Nr.	Nr.inv	Titulli i veprës	Përmasat	Teknika -Materiali të reja	Çmimi	Kodi QKIPK
1	196	Gjyshja e piktorit ,1956	36 x 45	Vaj / Kanavacë e plotë	300.000	22923
2	518	Zadrimorja ,1961	32 x 24	Vaj / Karton	250.000	5471
3	542	Kthim nga pazari,1957	51.9 x 84.8	Vaj / Kanavacë	150.000	5472
4	599	Motra Neta,1963	60,2 x78,6	Vaj / Kanavacë	350.000	5470
5	642	Mjelëset,1962	80 x 98	Vaj / Kanavacë	200.000	5476
6	1134	Saldatori ,1971	95 x 120.5	Vaj / Kanavacë e plotë	150.000	5473
7	1461	Gjimnazistja ,1973	60 x 81	Vaj / Kanavacë e plotë	100.000	5483
8	1506/1	"Vite lufte - cikël,1973" -Ndihma e shokut	23 x 31	Letër / Gjilpërë e thatë	20.000	5469
9	1506/3	"Vite lufte cikël,1973" -Shoku Enver	23 x 31	Letër / Gjilpërë e thatë	20.000	5469
10	1506/4	"Vite lufte cikël,1973" Pushim partizan	24 x 30,5	Letër / Gjilpërë e thatë	20.000	5469
11	1527	Portret vajze,1965	43.7 x 57	Vaj / Kanavacë	150.000	3418
12	1709	Portret i Mao Ce Dunit,1975	115x119	Vaj / Kanavacë	150.000	5479
13	1738	Portret i Shokut Enver Hoxha,1974	119.5 x 114.5	Vaj / Kanavacë e plotë	200.000	5491
14	1980	Shkrimtari Shëfqet Musaraj,1976	90 x 100.2	Vaj / Kanavacë	150.000	5475

15	2064	Kuvendi I Lezhës,1978	183 x 123	Vaj / Kanavacë	100.000	5484
16	2068	Pashko Vasa,1978	90 x 100	Vaj / Kanavacë	150.000	5482
17	2310	Natyre e qete me lahutë e çifteli ,1978	50 x 70	Vaj / Fajazit	100.000	5486
18	2451	Malësorja e vogel ,1975	50 x 41	Vaj / Kanavacë	150.000	5477
19	2553	Hidrocentrali i Fierzës, 1979	69 x 50	Vaj / Fajazit	100.000	5478
20	2554	Pejzazh , 1982	42.4 x 50	Vaj / Fajazit	100.000	5481
21	3125	Kallmetorja	45.5 x 56	Vaj / Kanavacë e plotë	100.000	5474
22	4527	Ded Gjon Luli në Deçiç,1963	102 x 151	Vaj / Kanavacë	300.000	71918